



Tiranë, më 13.06.2025

Lënda: Rreth procesit zgjedhor në Urdhrin e Psikologut dhe qëndrimit zyrtar të institucionit

Drejtuar: Mediave audiovizive dhe të shkruar

DEKLARATË PUBLIKE

Më datë **05 qershor 2025**, Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë organizoi procesin zgjedhor për organet e tij drejtuese, në përputhje me ligjin nr. 40/2016. Në këtë proces morën pjesë **451 anëtarë** nga **1480 anëtarë aktivë** të Asamblesë Kombëtare.

Pas përfundimit të afatit për paraqitjen e ankesave dhe në mungesë të tyre, **Këshilli Kombëtar**, si organi i vetëm ligjor me kompetencë për shqyrtimin dhe vlerësimin e vlefshmërisë së procesit zgjedhor, u mbledh më datë **13 qershor 2025 ora 13.00** dhe shqyrtoi në mënyrë të detajuar të gjithë dokumentacionin dhe ecurinë e procesit.

Këshilli Kombëtar konstatoi se procesi zgjedhor është zhvilluar në mënyrë të rregullt, të qetë dhe pa problematika procedurale apo organizative.

Megjithatë, pas shqyrtimit të rezultateve dhe dokumentacionit përkatës, u konstatua se **në këtë proces nuk është arritur shumica e thjeshtë e të gjithë anëtarëve të Asamblesë Kombëtare**, siç përcaktohet në **nenin 15, pika 3, germa “a” të ligjit nr. 40/2016**, dhe për këtë arsye **procesi nuk ka prodhuar një rezultat të vlefshëm që do të mundësonte shpalljen e fituesve në si për kategorinë President ashtu edhe për Këshillin Kombëtar.**

Për ta bërë sa më të qartë, në regjistrin zyrtar të anëtarësisë janë të regjistruar **1480 anëtarë aktivë**. Shumica e thjeshtë për të zgjedhur organet drejtuese është **741 pjesëmarrës**. Kjo shumicë nuk është arritur.

Ky standard ligjor, pra shumica e thjeshtë e të gjithë anëtarëve të regjistruar, ka qenë **konseguent në zbatim nga institucionet e Urdhrit**. Kjo u vu në praktikë edhe në **zgjedhjet e muajit korrik 2024**, kur për tre vende vakante në Këshillin Kombëtar, **procesi u konsiderua i pavlefshëm për shkak të mungesës së kuorumit, dhe asnjë kandidaturore nuk u shpall fituese.**

Këshilli Kombëtar vijon t’i kërkojë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe ministrive të tjera të linjës, të intensifikojnë komunikimin dhe të angazhohen për realizimin e ndryshimeve të nevojshme ligjore, me qëllim që të shmangen ngërçe të tilla në të ardhmen dhe të garantohet vijimësia e funksionimit institucional pa pengesa procedurale.

Në përputhje me këtë qasje institucionale dhe me vendimin e Këshillit Kombëtar, **Urdhri i Psikologut i bën thirrje të gjitha palëve të interesuara të respektojnë ligjshmërinë e procesit dhe të kontribuojnë në qetësimin e klimës publike.**

Urdhri i Psikologut thekson se **procedurat zgjedhore janë çështje ligjore, jo politike apo emocionale.** Ato trajtohen brenda institucioneve, përmes mekanizmave të parashikuar në ligj dhe në përputhje me vendimmarrjet e organeve kompetente.

Ky proces nuk ndikon në asnjë mënyrë në ushtrimin e përditshëm profesional nga më shumë se 1500 psikologë të licencuar, të cilët vijojnë punën e tyre me përkushtim dhe etikë në të gjitha fushat ku shërbejnë.